

20131473514

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR TË DREJTËN E AUTORIT
DHE TË DREJTA TË PËRAFËRTA

Neni 1

Në Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejta të përafërta ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 115/10 dhe 51/11) në nenin 52 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Kumtimi publik i titullit të shkrimit, artikullit dhe veprës tjetër të ngjashme për tema aktuale ekonomike, politike, religjioze dhe tema të ngjashme, në publikim elektronik të marrë nga publikim tjetër elektronik ose nga burim tjetër për njoftim të publikut është pa pagesë të kompensimit, përveç nëse kjo nuk ndalohet në mënyrë të veçantë nga autori, përkatësisht bartësi i të drejtës, me kusht që të shënohet burimi, si dhe emri i autorit nëse kjo është e mundshme."

Neni 2

Në nenin 94 fjalët: "paragrafi (1)" zëvendësohen me fjalët: "paragrafi (2)".

Neni 3

Në nenin 109 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Fonogram, në kuptimin e këtij ligji, është incizim i zërave nga shfaqja ose zërave tjerë ose dukurive të zërit, përveç në formë të incizimit të inkorporuar në vepër audiovizuale. Të drejtat mbi fonogramin në cilëndo mënyrë nuk janë të kufizuara me inkorporimin e fonogramit në videogram."

Neni 4

Në nenin 115 shtohet paragraf i ri (1), si vijon:

"(1) Organizatë radiotelevizive në kuptim të këtij ligji, është personi juridik që merr iniciativë, organizim, financim dhe përgjegjësi për emetim të parë radiodifuziv të programeve të veta."

Paragrafi (1) bëhet paragraf (2).

Neni 5

Në nenin 131 fjalia hyrëse ndryshohet si vijon: "Të drejta që në mënyrë kolektive menaxhohen, sipas rregullës, janë:".

Pika 10 ndryshohet si vijon:

"10) e drejta e riemetimit kabllorik të veprave të autorit dhe lëndë të të drejtave të përafërta, e cila si e drejtë ekskluzive, detyrimisht menaxhohet në mënyrë kolektive, përveç të drejtës së emetimit nga organizata radiotelevizive, pavarësisht nëse bëhet fjalë për të drejtën e saj personale ose e drejta i është bartur nga bartës tjetër i të drejtave."

Neni 6

Në nenin 135 paragrafi (1) fjalët: "pikat 1, 3 dhe 4" zëvendësohen me fjalët: "pikat 1 dhe 6".

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"Evidentimin e veprave të emetuara të autorit dhe lëndëve të të drejtave të përafërta, organizatat radiotelevizive e kryejnë në mënyrën e përcaktuar në nenin 135-a të këtij ligji."

Neni 7

Pas nenit 135 shtohet titull i ri dhe neni i ri 135-a, si vijon:

"Sistemi për evidencë elektronike

Neni 135-a

(1) Për evidencë elektronike, përpunim të të dhënave, ndjekje dhe kontroll mbi veprat e emetuara të autorit, përkatësisht lëndët e të drejtave të përafërta, organizatat për menaxhim kolektiv detyrohen të sigurojnë dhe instalojnë te organizatat radiotelevizive, sistem për evidencë elektronike të veprave të emetuara të autorit, përkatësisht lëndëve të të drejtave të përafërta.

(2) Leje për përdorimin e sistemit nga paragrafi (1) të këtij neni, me kërkesë të organizatës për menaxhim kolektiv, jep ministri i Kulturës, pas mendimit paraprak të ministrit për Shoqëri Informatike dhe Administratë.

(3) Organizatat radiotelevizive detyrohen që t'ia mundësojnë organizatës instalimin e sistemit nga paragrafi (1) të këtij neni dhe të sigurojnë sistem personal kompatibel me të cilin mundësohet kyçja në sistemin nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Mbikëqyrje mbi punën e sistemit nga paragrafi (1) të këtij neni kryen Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(5) Organizatat për menaxhim kolektiv, për kontroll dhe mbikëqyrje detyrohen që t'i mundësojnë Ministrisë së Financave - Drejtorisë së të Hyrave Publike qasje në sistemin nga paragrafi (1) të këtij neni.

(6) Formën, përmbajtjen dhe karakteristikat teknike të sistemit nga paragrafi (1) të këtij neni i përcakton ministri i Kulturës, pas mendimit paraprak nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës."

Neni 8

Në nenin 136 paragrafi (3) pas fjalëve: "administratës shtetërore" vihet presje dhe shtohen fjalët: "vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjet publike, institucionet publike, trupat e pavarur rregullatorë dhe organizatat që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin".

Neni 9

Titulli para nenit 137 dhe neni 137, ndryshohen si vijojnë:

"Baza për përcaktimin e kompensimeve, shfrytëzuesve dhe shfrytëzuesve përfundimtarë

Neni 137

(1) Kompensimet për shfrytëzimin e veprës së autorit, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta përcaktohen sipas bazave në vijim:

1) kur shfrytëzimi i veprës së autorit, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta është i domosdoshëm për kryerjen e veprimtarisë së shfrytëzuesit, përkatësisht të hyrat në veprimtari varen nga shfrytëzimi i tyre (realizimi publik i veprave të autorit dhe lëndëve të të drejtave të përafërta, pa dallim të dedikimit dhe hapësirës në të cilën realizohen si veprimtari e koncertit, interpretuese, veprimtari e vallëzimit dhe lloje tjera të shfrytëzimit, si vënia në dispozicion të publikut me kërkesë dhe ngjashëm), kompensimi për shfrytëzim përcaktohet, sipas rregullës, në përqindje nga të hyrat të cilat shfrytëzuesi i realizon me shfrytëzimin e veprës së autorit dhe/ose lëndës së të drejtave të përafërta;

2) kur me shfrytëzimin nga pika 1 të këtij paragrafi kompensimi nuk mund të përcaktohet në përqindje të të hyrave, atëherë ai përcaktohet në shumë me para që përkon me kontributin nga shfrytëzimi i veprave të autorit, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta në kryerjen e veprimtarisë;

3) kur shfrytëzimi i veprës së autorit, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta kryhet nga organizata radiotelevizive, kompensimi për shfrytëzim përcaktohet në shumë nominale e cila përcaktohet në varësi të llojit të veprës së autorit, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta

dhe përllogaritet në varësi të kohëzgjatjes së emetimit, përkatësisht shfrytëzimit në pajtim me sistemin e evidencës elektronike nga neni 135-a paragrafi (1) të këtij ligji ose kompensimi përcaktohet në përqindje të të hyrave që i përfshin mjetet e taksës radiodifuzive dhe/ose parapagesa, reklamat, sponsorimet, dotacionet dhe të hyrat nga qarkullimi i programeve. Si të hyra nuk konsiderohen mjetet e tatimit të vlerës së shtuar, mjetet nga kreditë dhe kamatat e kredive;

4) kur shfrytëzimi i veprës së autorit përkatësisht, lëndës të të drejtave të përafërta kryhet nga organizata radiotelevizive të cilat me ligj detyrohen të emetojnë vepra muzikore vokale dhe/ose vokale instrumentale në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e bashkësive etnike të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, në periudha dhe kohëzgjatje të përcaktuara me ligj, për shfrytëzimin e veprës së autorit dhe/ose lëndës së të drejtave të përafërta në këto raste, kompensimi përcaktohet në shumë për dhjetë herë të zvogëluar nga shuma e përcaktuar për emetimin radiodifuziv të veprave të autorit dhe/ose lëndëve të të drejtave të përafërta, në pajtim me bazat nga paragrafi (1) pika 3 të këtij neni;

5) kur shfrytëzimi i veprës së autorit, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta kryhet nga operatorët kabllorikë, kompensimi për shfrytëzim sipas rregullës përcaktohet sipas numrit të parapaguesve të operatorit i të cilët mundësohet shërbimi për riemetim të programeve të radios dhe televizive;

6) kur me shfrytëzimin e veprës së autorit, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta nuk realizohen të hyra (shfaqje, manifestime dhe ngjashëm), kompensimi përcaktohet në përqindje të shpenzimeve të nevojshme për shfrytëzimin e veprës së autorit, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta, siç janë kompensimet e autorëve, përkatësisht të bartësve të të drejtave të përafërta, shpenzimet për shfrytëzimin e hapësirës gjatë shfrytëzimit të veprës së autorit, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta dhe shpenzime tjera përkatëse;

7) gjatë përcaktimit të kompensimeve nga pikat 1, 2, 3 dhe 6 të këtij paragrafi, përcaktohet edhe shuma më e vogël nominale (absolute) e kompensimit dhe

8) kur shfrytëzimi i veprës së autorit, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta nuk është e domosdoshme për kryerjen e veprimtarisë së shfrytëzuesit, mirëpo kontribuon në rritjen e kënaqësisë të shfrytëzuesit përfundimtarë të shërbimeve të tyre (kapacitete akomodimi, hotele, hapësira për ekspozita, objekte hotelerike, mjete transporti dhe veprimtari tjera të ngjashme), kompensimi përcaktohet në shuma paushalle si për shfrytëzimet e përhershme dhe të përkohshme të veprës së autorit, përkatësisht lëndës së të drejtave të përafërta.

(2) Shfrytëzues në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni, është personi fizik ose juridik i cili e shfrytëzon të drejtën e autorit dhe/ose lëndën e të drejtave të përafërta për kryerje të veprimtarisë ose profesionit. Nëse më shumë shfrytëzues së bashku shfrytëzojnë vepër të autorit përkatësisht lëndë të të drejtave të përafërta, obligimet ndaj organizatës i përmbushin në mënyrë solidare, nëse me marrëveshje të ndërsjellë paraprake nuk janë marrë vesh ndryshe.

(3) Si shfrytëzues i fundit i shërbimeve të shfrytëzuesve nga paragrafi (1) të këtij neni në kuptim të këtij ligji, është personi fizik ose juridik, i cili si konsumator për konsum të drejtpërdrejtë personal për qëllime që nuk dedikohen për kryerjen e profesionit të tij ose për veprimtari tjera afariste, shfrytëzon shërbime në të cilat përfshihen vepra të autorit përkatësisht lëndë të të drejtave të përafërta.

(4) Organizata nuk ka të drejtë të kërkojë arkëtim të kompensimeve nga persona që janë shfrytëzues përfundimtarë nga paragrafi (3) të këtij neni. Marrëveshjet nga neni 139 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij ligji të lidhura në kundërshtim me këtë ligj janë të pavlefshme."

Neni 10

Në nenin 139 pas paragrafit (2) shtohet dy paragrafë të rinj (3) dhe (4), si vijojnë:

“(3) Marrëveshjet nga paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij neni detyrimisht përmbajnë të dhëna për lartësinë, kushtet për shfrytëzimin e veprave të autorit dhe lëndëve të të drejtave të përafërta, afatin dhe mënyrën e pagesës, rrethanat për të cilat lartësia e kompensimeve të caktuara rritet ose zvogëlohet, nëse rritja ose zvogëlimi i tillë parashihet.

(4) Për lloj dhe vëllim të njëjtë të shfrytëzimit të veprave të autorit dhe lëndëve të të drejtave të përafërta nga subjektet me veprimtari të njëjtë ose të përafërt, në marrëveshje të përgjithshme ose individuale nga paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij neni, nuk mund të përcaktohen shuma të kompensimeve për shfrytëzim, me të cilat prishet konkurrenca në treg."

Paragrafët (3) dhe (4) bëhen paragrafë (5) dhe (6).

Neni 11

Pas nenit 139 shtohet nënndarje e re si vijon: "Nënndarja 1. Procedura për miratimin e tarifës".

Neni 12

Titulli para nenit 140 dhe neni 140 ndryshohen si vijojnë:

"Thirrje publike

Neni 140

(1) Organizata është e detyruar që para miratimit të tarifës nga neni 139 paragrafi (1) pika 3 të këtij ligji, me shpallje të thirrjes të kërkojë mendim nga shfrytëzuesit, përkatësisht nga shoqatat përkatëse të shfrytëzuesve, përkatësisht dhomat e tyre.

(2) Thirrja publike nga paragrafi (1) i këtij neni, shpallet në mjetet për informim publik dhe në ueb faqen e organizatës dhe zgjat 30 ditë nga dita e shpalljes. Thirrja publike e përmban tekstin e propozim – tarifës. Nëse subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni gjatë kohëzgjatjes së thirrjes publike nuk dorëzojnë mendime të veta me shkrim në organizatë, do të konsiderohet se pajtohen me propozim – tarifën.

(3) Pas skadimit të afatit nga thirrja publike nga paragrafi (2) të këtij neni organizata në afat prej 15 ditësh përcakton propozim – tarifë dhe e dorëzon për mendim në Komisionin për Ndërmjetësim në Të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (në tekstin e mëtejme: Komisioni për Ndërmjetësim).

(4) Me kërkesën për mendim nga paragrafi (3) i këtij neni, organizata është e detyruar që t'i dorëzojë mendimet me shkrim te shfrytëzuesit me arsyetim për shkaqet për pranimin, përkatësisht mospranimin e tyre."

Neni 13

Pas nenit 140 shtohet titulli i ri dhe nen i ri 140-a, si vijojnë:

"Miratimi i tarifës

Neni 140-a

(1) Komisioni për Ndërmjetësim në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të propozim – tarifës nga neni 140 paragrafi (3) të këtij ligji, te organizata dhe te shfrytëzuesit që kanë dorëzuar mendime për propozim - tarifën nga neni 140 paragrafi (2) të këtij ligji, dorëzon mendim për propozim - tarifën.

(2) Mendimi nga paragrafi (1) i këtij neni përmban: vlerësim nëse propozim-tarifa e organizatës i përfshin të drejtat për të cilat ajo ka leje, vlerësim nëse kompensimet në propozim – tarifën janë të përcaktuara në pajtim me dispozitat e këtij ligji, vlerësim për lartësinë e kompensimeve, si dhe qëndrim lidhur me lëndën e mospajtit për propozim – tarifën ndërmjet organizatës dhe shfrytëzuesve.

(3) Organizata është e detyruar që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimin të mendimit nga paragrafi (1) të këtij neni, ta harmonizojë tekstin e propozim - tarifës me mendimin e Komisionit për Ndërmjetësim dhe tekstin e harmonizuar të propozim - tarifës ta dorëzojë në Komisionin për Ndërmjetësim.

(4) Komisioni për Ndërmjetësim, në afat prej dhjetë ditësh nga dita e dorëzimit të propozim – tarifës nga paragrafi (3) të këtij neni, propozim – tarifën me mendim të Komisionit për Ndërmjetësim për propozim – tarifën, e dorëzon në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për marrje të pëlqimit.

(5) Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton vendim për dhënien e pëlqimit përkatësisht vendim me të cilin nuk jepet pëlqim për propozim - tarifën nga paragrafi (4) të këtij neni.

(6) Tarifën për të cilën Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka miratuar vendim për dhënien e pëlqimit, organizata e dorëzon për shpallje në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(7) Nëse Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka miratuar vendim me të cilin nuk jep pëlqim për propozim - tarifën nga paragrafi (4) të këtij neni, Ministria e Kulturës në afat prej 30 ditësh me aktvendim të organizatës ia heq lejen për menaxhim kolektiv.

(8) Kundër aktvendimit nga paragrafi (7) të këtij neni, mund të ngritet kontest administrativ para gjykatës kompetente."

Nënndarja 1 bëhet Nënndarje 2.

Neni 14

Në nenin 141 paragrafi (1) fjalët: "ndërmjetësimi nga neni 140" zëvendësohen me fjalët: "kompetencat e përcaktuara në nenet 140 dhe 140-a".

Neni 15

Në nenin 142 paragrafi (1) presja pas fjalës "Maqedonisë" dhe fjalët: "me propozim të ministrit të Kulturës," shlyhen.

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Kryetari dhe anëtarët e Komisionit për Ndërmjetësim emërohen nga radhët e ekspertëve të shquar të pavarur dhe të paanshëm nga fusha e së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, ekonomisë, mbrojtjes së konkurrencës dhe shërbimeve të komunikimit."

Neni 16

Neni 144 ndryshohet si vijon:

"(1) Organizata miraton akt të përgjithshëm për ndarjen e kompensimeve në pajtim me ligjin dhe statutin, përkatësisht me marrëveshjen për themelim.

(2) Ndarja e kompensimeve nga paragrafi (1) të këtij neni bëhet në pajtim me evidencat dhe të dhënat për shfrytëzimin e veprave, përkatësisht lëndëve të të drejtave të përafërta, ndërsa me paushall kur nuk është e mundur ose shkakton shpenzime të paarsyeshme, sipas parimit të drejtësisë.

(3) Kompensimet nga emitimi radiodifuziv i veprave të autorit ose lëndëve të të drejtave të përafërta ndahen ndërmjet autorëve, përkatësisht bartësve të të drejtave të përafërta në bazë të të dhënave për pagesë të marra nga sistemi për evidencë elektronike të veprave të emetuara të autorit, përkatësisht lëndëve të të drejtave të përafërta nga neni 135 – a të këtij ligji.

(4) Mjetet e organizatës të realizuara nga kamatat e mjeteve të investuara në bankë dhe të hyrat tjera, në shumë prej 50% ndahen ndërmjet autorëve dhe bartësve të të drejtave të përafërta, proporcionalisht me pagesën e kompensimit që ato e kanë realizuar në pajtim me të dhënat për vepra të shfrytëzuara nga neni 135 paragrafi (1) të këtij ligji dhe në pajtim me evidencën elektronike nga neni 135 – a paragrafi (1) të këtij ligji, ndërsa 50% të tjera nga mjetet e organizatës të realizuara nga kamatat e mjeteve të investuara në bankë dhe të hyrat tjera ndahen në mënyrë që 70% ndahen ndërmjet autorëve dhe bartësve të të drejtave të përafërta, proporcionalisht me pagesën e kompensimit që ato e kanë realizuar në pajtim me të dhënat për vepra të shfrytëzuara nga neni 135 paragrafi (1) të këtij ligji dhe në pajtim me evidencën elektronike nga neni 135 – a paragrafi (1) të këtij ligji, ndërsa 30% u ndahen në mënyrë të barabartë të gjithë autorëve dhe bartësve të të drejtave të përafërta që janë të përfaqësuar në evidencën e autorëve dhe bartësve të të drejtave të përafërta të organizatës.

(5) Mjetet që organizata i grumbullon nga shfrytëzuesit, e llogariten në shuma paushalle, në shumë prej 70% ndahen ndërmjet autorëve dhe bartësve të të drejtave të përafërta, proporcionalisht me pagesën e kompensimit që ato e kanë realizuar në pajtim me të dhënat për vepra të shfrytëzuara nga neni 135 paragrafi (1) të këtij ligji dhe në pajtim me evidencën elektronike nga neni 135 – a paragrafi (1) të këtij ligji, ndërsa 30% të tjera u ndahen në mënyrë të barabartë të gjithë autorëve dhe bartësve të të drejtave të përafërta që janë të përfaqësuar në evidencën e autorëve dhe bartësve të të drejtave të përafërta të organizatës.

(6) Për mbulimin e shpenzimeve të përgjithshme për punën e organizatës mund të shfrytëzohen mjete nga grumbullimi i kompensimeve në shumë të përcaktuar në statutin, përkatësisht në marrëveshjen për themelim, por jo më shumë se 15%.

(7) Përlllogaritjet individuale dhe pagesat e kompensimeve të autorëve dhe bartësve të të drejtave të përafërta bëhen së paku një herë në vit e më së voni deri në fund të muajit mars në vitin rrjedhës për vitin paraprak.

(8) Akti i përgjithshëm për ndarje, pas miratimit të tij nga organi kompetent i organizatës, botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Neni 17

Në nenin 149 pas paragrafit (2) shtohen tre paragrafë të rinj (3), (4) dhe (5), si vijojnë:

“(3) Nëse me përjashtim nga paragrafi (2) të këtij neni për llojin e njëjtë të të drejtave janë lëshuar leje për menaxhim kolektiv të dy ose më shumë organizatave, organizatat detyrohen që në afat prej 60 ditësh nga dita e lëshimit të lejes së fundit për menaxhim kolektiv, të lidhin marrëveshje të ndërsjellë me të cilën do ta rregullojnë mënyrën në të cilën së bashku do të kryejnë menaxhim kolektiv me të drejtat.

(4) Organizatat nga paragrafi (3) të këtij neni, detyrohen që në afat prej pesë ditësh nga dita e lidhjes së marrëveshjes nga paragrafi (3) të këtij neni, marrëveshjen ta dorëzojnë në Ministrinë e Kulturës.

(5) Nëse në afat prej 60 ditësh nga dita e lëshimit të lejes nga paragrafi (3) të këtij neni, organizatat nuk lidhin marrëveshje të ndërsjellë, Ministria e Kulturës me propozim të Komisionit për Ndërmjetësim, në afat prej 30 ditësh me aktvendim do të përcaktojë se cila organizatë konsiderohet si e autorizuar për grumbullimin e kompensimeve për shfrytëzimin e veprave të autorit, përkatësisht lëndëve të të drejtave të përafërta dhe për ndarjen e tyre, duke pasur parasysh dokumentacionin nga neni 148 të këtij ligji.”

Paragrafi (3) bëhet paragraf (6).

Paragrafi (4) i cili bëhet paragraf (7) shlyhet.

Neni 18

Në nenin 150 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

“(3) Organizata që në pajtim me lejen grumbullon kompensime nga emitimi radiodifuziv i veprave të autorit dhe/ose lëndëve të të drejtave të përafërta, është e detyruar që në afat prej tetë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të aktvendimit për dhënie të lejes në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, të sigurojë dhe instalojë te organizatat radiotelevizive sistem për evidencë elektronike të veprave të autorit përkatësisht lëndëve të të drejtave të përafërta nga neni 135-a paragrafi (1) të këtij ligji.”

Paragrafi (3) i cili bëhet paragraf (4) ndryshohet si vijon:

“(4) Organizata fillon me punë më së voni 30 ditë nga dita e botimit të akteve nga paragrafi (2) të këtij neni, përkatësisht në rast të organizatës që grumbullon kompensime nga emitimi radiodifuziv i veprave të autorit dhe/ose lëndëve të të drejtave të përafërta në afat prej 30 ditësh nga dita e sigurimit dhe instalimit të sistemit për evidencë elektronike të veprave të emetuara të autorit përkatësisht lëndëve të të drejtave të përafërta nga neni 135 – a paragrafi (1) të këtij ligji.”

Paragrafi (4) i cili bëhet paragraf (5) ndryshohet si vijon:

“(5) Mosmiratimi i akteve në afatin nga paragrafi (2) të këtij neni përkatësisht mossigurimi i sistemit për evidencë elektronike të veprave të emituara të autorit përkatësisht lëndëve të të drejtave të përafërta nga neni 135 – a paragrafi (1) të këtij ligji në afatin nga paragrafi (3) të këtij neni, është bazë për heqje të lejes për menaxhim kolektiv.”

Neni 19

Neni 154 ndryshohet si vijon:

“(1) Organizata është e detyruar për çdo vit kalendarik në të cilin bëhet ndarja e kompensimeve, në afat prej gjashtë muajsh pas përfundimit të vitit kalendarik që:

1) të sigurojë raport të pavarur të revizorit për gjendjen financiare të organizatës dhe punës në kuptim të harmonizimit me këtë ligj, aktet e përgjithshme të organizatës dhe marrëveshjet e lidhura nga neni 139 paragrafi (1) pikat 1 dhe 2 të këtij ligji dhe

2) të dorëzojë raport financiar vjetor në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

(2) Organet kompetente të organizatës në pajtim me statutin përkatësisht marrëveshjen për themelim mund të kërkojnë:

1) raporte vjetore nga organet ekzekutive dhe mbikëqyrëse të organizatës për mjetet e grumbulluara, ndarjen e tyre, punën e organizatës dhe zbatimin e akteve për kompensime dhe zbatim të marrëveshjeve me shfrytëzuesit dhe me shoqatat e huaja përkatëse dhe

2) propozime për planin financiar dhe shpenzimet për punë për vitin e ardhshëm.

(3) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni nuk ndikojnë në obligimet e organizatës ndaj raporteve tjera financiare dhe revizioneve të ndërmarra në bazë të rregullave tjera.”

Neni 20

Pas nenit 156 shtohet titull i ri dhe nen i ri 156 - a, si vijojnë:

“Obligimet e organizatës

Neni 156-a

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes nga neni 156 të këtij ligji, organizata është e detyruar që Ministrisë së Kulturës t’i mundësojë qasje në hapësirat dhe pajisjen nga neni 148 pika 3 të këtij ligji, aktet e përgjithshme dhe të veçanta, dokumentacionin e plotë financiar, librat afaristë, dokumentet e kontabilitetit dhe dokumentacionin tjetër nga cilado formë dhe në çfarëdo formati.

(2) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes nga paragrafi (1) të këtij neni, nuk guxon të shkelet fshehtësia e të dhënave personale të autorëve përkatësisht bartësve të të drejtave të përafërta të përfshira në dokumentacionin nga paragrafi (1) të këtij neni.”

Neni 21

Neni 158 ndryshohet si vijon:

“Organizata është e detyruar që në faqen e vet të internetit t’i shpallë:

1) të dhënat për numrin e anëtarëve;

2) kategoritë e shfrytëzuesve të lëndës për mbrojtje që janë të detyruar t’i paguajnë kompensim organizatës;

3) aktet e përgjithshme të organizatës (statutin dhe rregulloret);

4) marrëveshjet e lidhura të përgjithshme dhe të veçanta;

5) marrëveshjet bilaterale të lidhura me organizata të huaja;

6) të dhënat për përfaqësuesit e organizatës;

7) raportet për punë dhe për kompensimet e grumbulluara nga shfrytëzimi i veprave përkatësisht lëndëve të të drejtave të përafërta;

8) të dhënat për dhjetë veprat më të shfrytëzuara të autorit përkatësisht lëndët e të drejtave të përafërta;

9) raportet për ndarjen e kompensimeve të grumbulluara dhe

10) konstatimin nga raporti i revizorit nga neni 154 paragrafi (1) pika 1 të këtij ligji.”

Neni 22

Neni 182 ndryshohet si vijon:

(1) Gjobë në shumë prej 10 000 deri në 15 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, i cili:

- në mënyrë të pahijshme e shfrytëzon krijimtarinë popullore dhe nuk e cek burimin dhe origjinën (neni 53 paragrafi (2)),

- nuk e njofton dhe nuk dorëzon informata, dokumente dhe të dhëna, nuk i paguan shumë përkatëse të kompensimeve organizatës përkatëse për menaxhim kolektiv në afat të caktuar dhe nuk mundëson qasje në dokumentacion (neni 135 paragrafët (1), (2) dhe (3)),

- pa prolongim nuk e njofton organizatën përkatëse për menaxhimin kolektiv për çdo ndryshim të rrethanave të shfrytëzimit ose për shuarjen e tij (neni 135 paragrafi (5)) dhe

- nuk mundëson qasje dhe shfrytëzim të veprës përmes heqjes së masave teknologjike ose mjeteve tjera të personit i cili ka qasje ligjore në rast të përjashtimeve dhe kufizimeve të të drejtës të përcaktuara në Kapitullin e dytë pjesa 4 të këtij ligji (neni 164).

(2) Gjobë në shumë prej 5 000 deri në 8 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 3 000 deri në 4 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni, tregtarit individ.

(4) Gjobë në shumë prej 3 000 deri në 4 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni, personit fizik.

(5) Për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni personit juridik mund t'i shqiptohet ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej një deri në dy vjet.

(6) Për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni tregtarit individ mund t'i shqiptohet ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej një deri në dy vjet.”

Neni 23

Titulli para nenit 183 dhe neni 183, ndryshohen si vijojnë:

"Gjobë për Organizatën RTV

Neni 183

(1) Gjobë në shumë prej 20 000 deri në 30 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje organizatës radiotelevizive e cila nuk do t'i mundësojë organizatës instalimin e sistemit nga neni 135-a paragrafi (1) të këtij ligji (neni 135-a paragrafi (3)).

(2) Gjobë në shumë prej 10 000 deri në 15 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës te personi juridik."

Neni 24

Titulli para nenit 184 dhe neni 184, ndryshohen si vijojnë:

"Gjobë për organizatën

Neni 184

(1) Gjobë në shumë prej 20 000 deri në 50 000 uero në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet organizatës, nëse:

- kryen arkëtimin e kompensimit nga personi juridik ose fizik i cili është shfrytëzues përfundimtar në kuptimin e nenit 137 paragrafi (3) të këtij ligji (neni 137 paragrafi (4)),

- për llojin dhe vëllimin e njëjtë të shfrytëzimit të veprave të autorit dhe lëndëve të të drejtave të përafërta nga subjekte me veprimtari të njëjtë ose të përafërt, me marrëveshje të përgjithshme përcakton shuma më të larta të kompensimit për shfrytëzim nga ato që janë përcaktuar në Tarifë, përkatësisht me marrëveshje individuale përcakton shuma më të larta të kompensimit për shfrytëzim se ato që janë përcaktuar në marrëveshjen e përgjithshme, përkatësisht Tarifë (neni 139 paragrafi (2)),

- për llojin dhe vëllimin e njëjtë të shfrytëzimit të veprave të autorit dhe lëndëve të të drejtave të përafërta nga subjekte me veprimtari të njëjtë ose të ngjashme, në marrëveshje të përgjithshme ose individuale, përcakton shuma të ndryshme të kompensimeve për shfrytëzim me çfarë priset konkurrenca e tregut (neni 139 paragrafi (4)) dhe

- së paku një herë në vit nuk kryen pagesë të kompensimeve (neni 144 paragrafi (7)).

(2) Gjobë në shumë prej 10 000 deri në 30 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) të këtij neni edhe personit përgjegjës te personi juridik."

Neni 25

Titulli para nenit 185 dhe neni 185, ndryshohen si vijojnë:

"Gjobë për organizatën për mospagimin e llogaridhënies dhe transparencës në punë

Neni 185

(1) Gjobë në shumë prej 10 000 deri në 15 000 uero në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet organizatës, nëse:

- nuk siguron raport të pavarur të revizorit (neni 154 paragrafi (1) pika 1),

- nuk dorëzon raport financiar vjetor te Qeveria e Republikës së Maqedonisë (neni 154 paragrafi (1) pika 2) dhe

- në ueb faqen e vet nuk i publikon të dhënat dhe aktet nga neni 158 të këtij ligji (neni 158).

(2) Gjobë në shumë prej 5 000 deri në 8 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni dhe personit përgjegjës në personin juridik."

Neni 26

Titulli para nenit 186 dhe neni 186, ndryshohen si vijojnë:

"Gjobë për kryetarin dhe anëtarët e Komisionit për Ndërmjetësim

Neni 186

Gjobë në shumë prej 7 500 deri në 15 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit për Ndërmjetësim në të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta nëse nuk veprojnë në afatet nga neni 140-a paragrafët (1) dhe (4) të këtij ligji."

Neni 27

Titulli para nenit 187 dhe neni 187, ndryshohen si vijojnë:

"Gjobë për personin përgjegjës në Ministrinë e Kulturës

Neni 187

Gjobë në shumë prej 7 500 deri në 15 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit përgjegjës në Ministrinë e Kulturës nëse nuk vepron në afatin nga neni 140-a paragrafi (7) i këtij ligji."

Neni 28

Pas nenit 195 shtohet titull i ri dhe nen i ri 195-a, si vijojnë:

“Evidenca e autorëve dhe bartësve të të drejtave të përafërta

Neni 195-a

(1) Ministria e Kulturës mban evidencë të autorëve dhe bartësve të të drejtave të përafërta të cilët janë shtetas të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht e kanë selinë e tyre në Republikën e Maqedonisë.

(2) Evidenca nga paragrafi (1) të këtij neni mbahet në bazë të kërkesës së autorit, përkatësisht bartësit të së drejtës së përafërt të dorëzuar në Ministrinë e kulturës.

(3) Mënyrën e grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, formularin e kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni dhe përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri i Kulturës.”

Dispozita kalimtare dhe të fundit

Emërimi i Komisionit për Ndërmjetësim në të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta

Neni 29

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji e emëron Komisionin për Ndërmjetësim në të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta. Komisioni për Ndërmjetësim në të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta i emëruar në pajtim me Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 115/10 dhe 51/11), vazhdon me punën deri në emërimin e Komisionit për Ndërmjetësim në të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta në pajtim me këtë ligj.

Harmonizimi i punës së organizatave

Neni 30

Organizatave për menaxhim kolektiv me të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta që kanë leje për menaxhim kolektiv dhe kanë filluar me punë në pajtim me nenin 150 paragrafi (3) të Ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 115/10 dhe 51/11) detyrohen që në afat prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji ta shpallin thirrjen publike nga neni 12 paragrafi (1) të këtij ligji dhe në afat prej katër muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji t’i harmonizojnë aktet dhe punën me dispozitat e këtij ligji.

Nëse organizatat nga paragrafi (1) i këtij neni në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk e shpallin thirrjen publike nga neni 12 të këtij ligji dhe në afat prej katër muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk i harmonizojnë aktet dhe punën me dispozitat e këtij ligji, Ministria e kulturës me aktvendim do ta heqë lejen për menaxhim kolektiv.

Organizatave nga paragrafi (1) i këtij neni detyrohen që në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji ta sigurojnë sistemin për evidencë elektronike nga neni 7 paragrafi (1) i këtij ligji.

Nëse organizatat nga paragrafi (3) të këtij neni nuk e sigurojnë sistemin për evidencë elektronike në afatin nga paragrafi (3) të këtij neni, Ministria e Kulturës me aktvendim do ta heqë lejen për menaxhim kolektiv.

Procedura të filluara

Neni 31

Procedurat për marrje të lejes për menaxhim kolektiv me të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta të filluara në pajtim me Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 115/10 dhe 51/11) do të përfundohen në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Procedurat për miratim të statutit, tarifës dhe aktit të përgjithshëm për ndarje të kompensimeve të organizatës për menaxhim kolektiv me të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta të filluara në pajtim me Ligjin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 115/10 dhe 51/11) do të përfundojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Akte nënligjore

Neni 32

Ministria e Kulturës do t’i miratojë aktet nënligjore të këtij ligji në afat prej dy muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.